VENDIM
Nr.807, datë 30.11.2011

PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre", si dhe të pikës 8 të kreut VI të Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zie kombëtare të datës 3 dhjetor 2011, ditë e zhvillimit të ceremonisë funebre shtetërore, në nderim të të ndjerit Leka ZOGU I (pretendent i Fronit Mbretëror të Shqiptarëve).

2. Në të gjitha institucionet, shtetërore dhe publike, të ulet flamuri kombëtar në gjysmë shtize dhe në orën 12.00 të mbahet një minutë heshtje.

3. Radio-Televizioni Publik Shqiptar, gjatë zhvillimit të ceremonialit, të transmetojë muzikë funebre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha